



REPUBLIKA E SHQIPÉRISÉ



**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT  
DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE  
KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

Nr. 3243 Prot

Datë 26 / 10 /2018

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

Nr. 1210 Prot

Datë 26 / 10 /2018

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**

Lidhur ndërmjet

**PALËVE:**

**INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE, (në vijim referuar si ILDKPKI)** përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm Z. Shkëlqim GANAJ,

Dhe:

**KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT, (në vijim referuar si KLSH)** përfaqësuar nga Kryetari Z. Bujar LESKAJ,

**DUKE KUJTUAR**

se Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave nga njëra anë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit nga ana tjetër kanë si synim të përbashkët realizimin sa më të mirë të misioneve dhe objektivave të tyre institucionale;

**DUKE KONSIDERUAR**

qëllimin e përbashkët për forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korruptionit, përbushjen e rekomandimeve të Komisionit European në drejtim të integrimit europian, parandalimin, trajtimin dhe ndëshkimin e veprimeve që cënojnë mirëfunkcionimin e administratës publike, me fokus të veçantë garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në

interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij ndaj institucioneve publike, nëpërmjet parandalimit të konfliktit të interesave;

**DUKE SYNUAR**

që ky bashkëpunim do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në këtë fushë;

**DUKE RIAFIRMUAR**

vendosmërinë për respektimin rigoroz të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit të fushave përkatëse, gjatë proceseve respektive të punës së të dy institucionave,

**PALËT** bien dakort të forcojnë bashkëpunimin dhe zhvillojnë marrëdhëniet ndërmjet institucioneve, si më poshtë:

**Neni 1**  
**Baza Ligjore**

1. Baza ligjore e kësaj marrëveshje është Ligji nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, i ndryshuar; Ligji nr. 9367, datë 7.4.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, i ndryshuar, dhe Ligji nr.154/2014 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

1. Realizimi i bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërmjet palëve, për shkëmbimin e informacioneve për subjektet që mbartin detyrimin për deklarim të interesave private në ILDKPKI, me qëllim evidentimin e saktë të rasteve të konfliktit të interesit gjatë procedurave të prokurimeve publike dhe nënshkrimit, zbatimit të kontratave administrative.
2. Rritja e efikasitetit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe korruptionit.
3. Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta për hetimin administrativ dhe referimeve pranë strukturave përgjegjëse për hetimin penal të subjekteve që mbartin detyrim për deklarim të interesave private.
4. Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të Palëve në këtë Marrëveshje.

### **Neni 3 Objekti**

1. Palët do të bashkëpunojnë për shkëmbimin e informacionit në lidhje me rastet e konfliktit të interesave të konstatuara gjatë kontrollit të procedurave të prokurimit publik dhe kontratave administrative.
2. Palët do të bashkëpunojnë në mbledhjen, zhvillimin dhe analizimin e informacionit që do të shkëmbejnë në lidhje me rastet e konfliktit të interesave të konstatuara gjatë kontrollit të procedurave të prokurimit publik dhe kontratave administrative.
3. Palët angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit.

### **Neni 4 Kontributi i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave**

1. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave merr përsipër që në përfundim të kontrolleve të deklaratave të interesave private të subjekteve që mbartin detyrimin për deklarim, të ushtruar në zbatim të përcaktiveve ligjore dhe në rast zbulimi të parkikave abuzive, korruptive apo arbitrale dhe atëherë kur konstaton cënimin e interesave pasurore të shtetit, të cilat janë objekt i aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, t'i dërgojë Kryetarit të KLSH, një kopje të dokumentave të nevojshëm në një kohë sa më të shpejtë.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave merr përsipër që, në përfundim të kontrolleve të inicuara mbi bazën e informacionit të marrë nga Kontrollli i Lartë i Shtetit të informojë këtë të fundit për rezultatet e këtyre kontrolleve.

### **Neni 5 Kontributi i Kontrolli të Lartë të Shtetit**

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të njoftojë në një kohë sa më të shpejtë ILDKPKI për rastet kur, gjatë kontrolleve, konstaton praktika abuzive, korruptive apo arbitrale nga ana e zyrtarëve, të cilët janë subjekti të Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike”, i ndryshuar; si dhe Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe për rezultatet e arritura në vijim të informacioneve të marra nga ILDKPKI.
2. Kontrolli i Lartë i Shtetit merr përsipër të njoftojë në çdo rast ILDKPKI për rastet e prokurimeve publike dhe kontratave administrative kur dyshohet se janë nxjerrë në

kushtet e konfliktit të interesit, si dhe për rezultatet e arritura në vijim të informacioneve të marra nga ILDKPKI.

## Neni 6

### Kontributo të Përbashkëta

1. ILDKPKI dhe KLSH marrin përsipër të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin për rezultatet e hetimit të rasteve abuzive, korruptive apo arbitrale të denoncuara prej tyre që lidhen me fushën e veprimit të seilit institucion.
2. ILDKPKI dhe KLSH marrin përsipër të bashkëpunojnë për organizimin e aktivitetave të përbashkëta, si për t'i ofruar njëri-tjetrit shërbime të ekspertizës dhe trajnimit për fushat respektive të veprimtarisë, ashtu edhe për të rritur ndërgjegjësimin e administratës publike në parandalimin dhe shmangjen e paraktivave korruptive dhe abuzuese.
3. ILDKPKI dhe KLSH angazhohen që të zhvillojnë aktivitete trajnuese të përbashkëta në lidhje me çështje të prandalimit, trajtimit dhe sanksionimit të konfliktit të interesave gjatë procedurave të prokurimeve publike.
4. ILDKPKI dhe KLSH angazhohen për të thelluar më tej bashkëpunimin midis tyre nëpërmjetë pjesëmarries së ekspertëve të ILDKPKI në grupet e auditimit të KLSH për çështje që lidhen me konfliktin e interesit.

## Neni 7

### Bashkërendimi i punëve ndërmjet palëve

1. Palët caktojnë një person kontakti që do të jetë përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.
2. Palët brenda 20 ditëve nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes njoftojnë me shkresë zyrtare emrat e personave të kontaktit (e-mail, numër telefoni). Njoftimi i ndryshimit të personave të kontaktit do të bëhet në të njëjtën mënyrë.
3. Personat e kontaktit zhvillojnë takime ndërmjet tyre, në varësi të nevojave për shkëmbim informacioni.
4. Shkëmbimi i informacionit do të bëhet në formë shkresore dhe elektronike, por në çdo rast përmes personave të kontaktit.
5. Personat e kontaktit do të informojnë në vazhdimësi drejtuesit e dy institucioneve lidhur me problematikat e konstatuara gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje.

**Neni 8**  
**Administrimi i dokumentacionit dhe informacionit**

1. Gjatë zbatimit të marrëveshjes të gjitha të dhënata e shkëmbyera ndërmjet palëve do të konsiderohen konfidenciale.
2. Çdo palë do t'a trajtojë informacionin në zbatim të dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, Ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënavë personale*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “*Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”*”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në fuqi.

**Neni 9**  
**Rishikimi dhe monitorimi i zbatimit**

1. Palët bëjnë shtesa dhe ndryshime në këtë marrëveshje, bazuar në pëlqimin e ndërsjelltë të paraqitur me shkrim.
2. Marrëveshja e miratuar dhe zbatimi i saj monitorohen në mënyrë periodike

**Neni 10**  
**Përfundimi i Marrëveshjes**

1. Kjo Marrëveshje mund të përfundojë nga secila Palë nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, tre (3) muaj pas datës së marrjes të njoftimit të sipërpërmendur.
2. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, palët do t'u përbahen termave dhe kushteve që rrjedhin prej saj, përsa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara datës së përfundimit.

**Neni 11**  
**Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar.
2. Kjo marrëveshje hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga përfaqësuesit e palëve.
3. Me hyrjen në fuqi të kësaj marrëveshje shfuqizohet Marrëveshja e datës 02.03.2012.
4. Marrëveshja, hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Inspektoratin e Lartë të

Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dhe dy të tjera  
në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, në datë 26 / 10.2018

**PËR INSPEKTORATIN E LARTË TË  
DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË  
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË  
INTERESAVE**

**INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM  
SHKËLQIM GANAJ**



**PËR KONTROLLIN E LARTË TË  
SHTETIT**

